Cofinanziato
dall'Unione europea

MINISTERO
DELL'INTERNO

**FONDO ASILO, MIGRAZIONE E INTEGRAZIONE 2014-2020**

Obiettivo Specifico 2 Integrazione/Migrazione legale – Obiettivo Nazionale 3 Capacity Building

PROG – 3844 POSTER – POTENZIAMENTO SERVIZI TERRITORIALI PER IL DIALOGO INTERCULTURALE

# BASHKIMI FAMILJAR

**kërkesa**
për dokumentet e nevojshme
**procedura**
e regjistrimit në gjendjen civile



**rishikimi i fundit**: nëntor 2023

Prefettura di Reggio Emilia

POSTER
POtenziamento Servizi Territoriali per il dialogo intERculturale

FONDAZIONE E35
PER LA PROGETTAZIONE INTERNAZIONALE

Centro Interculturale MONDINSIEME Intercultural Centre

caleidos COOPERATIVA SOCIALE

# PËR KË MUND TË KËRKOHET
BASHKIMI FAMILJAR?

- BASHKËSHORTIN/EN
- FËMIJËT E MITUR
- FËMIJËT ME MOSHË MADHORE ME PAAFTËSI TOTALE 100%
- PRINDËR NË NGARKIM

# KUSH MUND TA KËRKOJË
BASHKIMIN FAMILJAR?

## PERSONAT E PAJISUR ME:

**KARTË QËNDRIMI BE**
(D. Lgjs. 30/2007)

**LEJEQËNDRIMI BE**
për personat me qëndrimpër një periudhë të gjatë

**KARTA BLU BE**

**LEJEQËNDRIMI**
me afat jo më pak se një vit

**lëshuar për:**
Strehim politik* | Mbrojtje ndihmëse* | Punë vartëse | Vetëpunësim | Motive familjare | Motive fetare | Studime | Lejeqëndrimi ICT (Intercorporate transfers) (pavarësisht nga kohëzgjatja) | Kërkime shkencore (pavarësisht nga kohëzgjatja)

*në këto dy raste nuk është e nevojshme të paraqiten dokumente që kanë të bëjnë me banesën dhe të ardhurat

Është e rëndësishme të sillni me vete lejen e qëndrimit, sidomos kur komunikoni me zyrat publike.

Prefettura di Reggio Emilia
POSTER POtenziamento Servizi Territoriali per il dialogo intERculturale
FONDAZIONE E35 PER LA PROGETTAZIONE INTERNAZIONALE
Centro Interculturale MONDINSIEME Intercultural Centre
caleidos COOPERATIVA SOCIALE

BASHKIMI FAMILJAR

# DOKUMENTET E NEVOJSHME

**PULLË TAKSE**

16 EURO

**Vetëdeklarim monogamie**
(në rastin e bashkëshortëve)

SHKARKO KËTU DOKUMENTIN

**Vetëdeklarim sigurimi për prindërit mbi 65 vjeç**

SHKARKO KËTU DOKUMENTIN

## DOKUMENTET E KËRKUESIT

**PASAPORTË**
Të vlefshme

**LEJE QËNDRIMI**
Të vlefshme

**KARTË IDENTITETI**
Të vlefshme

**GJENDJA FAMILJARE DHE REZIDENCA:**
Vetëdeklarim

SHKARKO KËTU DOKUMENTIN

## DOKUMENTET E FAMILJARËVE

**PASAPORTË**
Të vlefshme

Prefettura di Reggio Emilia
POSTER POtenziamento Servizi Territoriali per il dialogo intERculturale
FONDAZIONE E35 PER LA PROGETTAZIONE INTERNAZIONALE
Centro Interculturale MONDINSIEME Intercultural Centre
caleidos COOPERATIVA SOCIALE

BASHKIMI FAMILJAR

# BANESA E KËRKUESIT

## PËRSHTATSHMËRIA E BANESËS

**Komuna Reggio Emilia:**
ACER

**Komunat e tjera të provincës:**
ZYRAT KOMUNALE KOMPETENTE

## MIRATIMI I PRONARËVE TË BANESËS

**MODELI "S1"**
(për të miturit) dhe
**MODELI "S2"**
(për të rriturit)

**+ KOPJA E KARTËS SË IDENTITETIT**

(nëse jeni nënshtetas i një Vendi të Tretë është e nevojshme të paraqitni Lejeqëndrimin)

SHKARKO KËTU DOKUMENTIN

## KONTRATA E QIRASË / CERTIFIKATË PRONËSIE

**+ DËFTESA E REGJISTRIMIT**

**Nuk kam një banesë të përshtatshme, çfarë duhet të bëj?**
ËSHTË e mundur të tregohet një banesë e ndryshme nga ajo e rezidencës së aplikuesit për anëtarët e familjes që do të bashkohen.

# TË ARDHURAT

Për lëshimin e lejes është e nevojshme të vërtetoni se keni të ardhura minimale.
Tabelat referuese mund të gjenden në faqen e internetit të Prefekturës.
*https://www.prefettura.it/reggioemilia/contenuti/Procedura_per_il_rilascio_del_nulla_osta_in_italiano_e_multilingua-17446848.htm*

## PUNONJËS ME PUNË VARTËSE

**MODELI UNILAV**
I kërkohet punëdhënësit tuaj

**DEKLARATA E TË ARDHURAVE**

**BUSTA PAGA (rrogat)**
E 12 muajve të fundit

**VETËDEKLARIM I PUNËDHËNËSIT**
MODELI "S3"
**+ KOPJA E KARTËS SË IDENTITETITME**

SHKARKO KËTU DOKUMENTIN

Prefettura di Reggio Emilia · POSTER POtenziamento Servizi Territoriali per il dialogo intERculturale · FONDAZIONE E35 PER LA PROGETTAZIONE INTERNAZIONALE · Centro Interculturale MONDINSIEME Intercultural Centre · caleidos COOPERATIVA SOCIALE

## PUNONJËS I VETËPUNËSUAR

**CERTIFIKATA E DHOMËS SË TREGTISË**
i kërkohet konsulentit tatimor

**AKTI I THEMELIMIT**
për ortakët: i kërkohet noterit dhe/ose konsulentit tatimor

**BILANCI**
i kërkohet konsulentit tatimor

**CERTIFIKATA E DHËNIES SË NUMRIT NIPT**
i kërkohet konsulentit tatimor

**LICENCA KOMUNALE**

## PUNËTOR SHTËPIAK

**KOMUNIKIMI I DETYRUESHËM**
i kërkohet punëdhënësit

**DEKLARATA E TË ARDHURAVE**

**BULETINET INPS**
të 4 tremujorëve të fundit

**+ DËFTESA E PAGESËS**
i kërkohet punëdhënësit tuaj

**VETËDEKLARIM I PUNËDHËNËSIT**
MODELI "S3"

**+ KOPJA E KARTËS SË IDENTITETIT**

SHKARKO KËTU DOKUMENTIN

**Nëse të ardhurat e mia nuk janë të mjaftueshme, çfarë mund të bëj?**

ËSHTË e mundur t'i kërkoni një anëtari të familjes t'i integrojë (plotësojë): për të arritur të ardhurat minimale të kërkuara sipas ligjit, eventualisht mund të merren parasysh edhe çeqet familjare, ose të ardhurat e subjekteve të cilët janë nën të njëjtin status familjar me personin që ka kërkuar bashkim familjar.
Është e nevojshme të vërtetohet shkalla e lidhjes familjare (P.sh. bashkëshorti, fëmija, prindi, vëllai/motra).
Në këtë rast ju duhet:

**DOKUMENTACIONI QË VËRTETON LIDHJET FAMILJARE, EVENTUALISHT I PËRKTHYER DHE I LEGALIZUAR ose i APOSTILUAR**

**DEKLARATA E SHPREHJES SË DËSHIRËS PËR INTEGRIMIN E TË ARDHURAVE**

**DOKUMENTET E TË ARDHURAVE**

Prefettura di Reggio Emilia
POSTER POtenziamento Servizi Territoriali per il dialogo intERculturale
FONDAZIONE E35 PER LA PROGETTAZIONE INTERNAZIONALE
Centro Interculturale MONDINSIEME Intercultural Centre
caleidos COOPERATIVA SOCIALE

BASHKIMI FAMILJAR

# PROCEDURA

## 1 SI DUHET TA PARAQITNI KËRKESËN

Kërkesa për autorizim (nulla osta) për bashkim familjar mund të dërgohet vetëm në mënyrë digjitale nëpërmjet portalit të dedikuar të Ministrisë së Brendshme
https://portaleservizi.dlci.interno.it/AliSportello/ali/home.htm.
**QASJA BËHET ME SPID**

Më pas qytetari do të marrë me e-mail një kod identifikimi (RE.......)

Këtu është e mundur të plotësoni dhe të dërgoni on-line formularin e kërkesës për autorizim bashkimi familjar, duke bashkëlidhur në këtë fazë të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

Adresat e-mail të treguara gjatë plotësimit të kërkesës do të përdoren për të gjitha komunikimet në lidhje me procedurën. Prandaj është e këshillueshme që të kontrolloni rregullisht postën elektronike.

## 2 THIRRJA E PARË NË SPORTEL DHE PARALAJMËRIMI PËR MOSPRANIM

Personi që bën kërkesën merr një komunikim të quajtur "paralajmërim mospranimi" me të cilin thirret në sportel.

Nuk do të thotë se praktika është refuzuar por që për të vazhduar është e nevojshme të shtohen dokumente të tjera.

Prefettura di Reggio Emilia
POSTER POtenziamento Servizi Territoriali per il dialogo intERculturale
FONDAZIONE E35 PER LA PROGETTAZIONE INTERNAZIONALE
Centro Interculturale MONDINSIEME Intercultural Centre
caleidos COOPERATIVA SOCIALE

Në komunikim tregohen arsyet penguese eventuale dhe dokumentet për përfundimin e praktikës: më pas thirret personi kërkues për të dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

Komunikimi dërgohet në adresën e e-mailit të dhënë gjatë fazës së regjistrimit dhe përmban datën, orën dhe adresën e takimit.
*Nëse nuk është e mundur të paraqiteni në takim, është e nevojshme ta komunikoni këtë me një e-mail në adresën economia.pref_reggioemilia@interno.it, duke futur të dhënat e mëposhtme: mbiemrin, emrin, adresën e e-mailit, numrin e telefonit dhe mesazhin.*

## MOSPRANIMI

**Mospranimi është refuzimi i autorizimit.**

Vendimi i mospranimit njoftohet në Portalin ALI dhe përmban arsyet për të cilat kërkesa nuk u pranua.

Personi kërkues mund të ankohet në Gjykatë, duke iu drejtuar gjykatës së rrethit brenda 60 ditëve.

## NULLA OSTA (AUTORIZIMI)

**Nëse plotësohen të gjitha kërkesat, Prefektura ia transmeton autorizimin në mënyrë elektronike Autoritetit Diplomatik ose Konsullor Italian në vendin e anëtarit të familjes që do të bëjë bashkimin familjar.**

Anëtari i familjes në vendin e origjinës duhet të dorëzojë më pas kërkesën për vizë për arsye familjare pranë Ambasadës ose Autoritetit Konsullor Italian.

Personi kërkues do të informohet për lëshimin e autorizimit (nulla osta) me anën e e-mailit dhe që mund të shkarkohet nga Portali ALI.

Autorizimi është i vlefshëm për 6 muaj nga data e lëshimit dhe afati nuk mund të zgjatet. VIZA E HYRJES (VIZA) duhet të kërkohet brenda këtij afati.

Prefettura di Reggio Emilia
POSTER POtenziamento Servizi Territoriali per il dialogo intERculturale
FONDAZIONE E35 PER LA PROGETTAZIONE INTERNAZIONALE
Centro Interculturale MONDINSIEME Intercultural Centre
caleidos COOPERATIVA SOCIALE

## 3 LËSHIMI I VIZËS

Viza e hyrjes për arsye familjare lëshohet nga Autoriteti konsullor ose diplomatik, pas kontrolleve të nevojshme.
**Do të kërkohet dokumentacioni i ri** (Konsullata e referimit).

**PASI TË LËSHOHET VIZA NË PASAPORTËN TUAJ, AJO ËSHTË E VLEFSHME PËR 1 VIT.**

Anëtarët e familjes së ribashkuar, të cilët, pas lëshimit të vizës së hyrjes, hyjnë në territorin italian, duhet të ndjekin udhëzimet e treguara në seksionin HYRJA E PARË.

## 4 HYRJA E PARË

Pasi të ketë marrë vizën, shtetasi i huaj mund të hyjë në Itali dhe, brenda 8 ditësh pune, duhet të bëjë kërkesën te prefektura që ka miratuar autorizimin për të kërkuar takimin e parë me qëllim që të regjistrojë hyrjen e parë.

Takimi merret në Portalin ALI
https://portaleservizi.dlci.interno.it/AliSportello/ali/home.htm.

Personi kërkues duhet të shkojë te "Prenotimi i takimeve", **të fusë Kodin e identifikimit të kërkesës** të lidhur me SPID-in e tij dhe të zgjedhë "Hyrja e parë". Hapet një kalendar me datat e disponueshme për takimet në Prefekturë.

Në këtë takim duhet të dorëzohet Deklarata e mikpritjes (Për rezidentët e komunës së Reggio Emilia kjo deklaratë paraqitet në Kuesturë, për komunat e tjera është e nevojshme të kërkohen informacione te komuna e vendbanimit).

Prefettura di Reggio Emilia
POSTER POtenziamento Servizi Territoriali per il dialogo intERculturale
FONDAZIONE E35 PER LA PROGETTAZIONE INTERNAZIONALE
Centro Interculturale MONDINSIEME Intercultural Centre
caleidos COOPERATIVA SOCIALE

Në këtë takim do të regjistrohet hyrja e parë dhe do të plotësohen dokumentet që i bashkëlidhen kërkesës për lejeqëndrim së bashku me kit-in postar (Poste Italiane).

Gjithashtu, me rastin e takimit të parë në Prefekturë, në rastin e shtetasve me moshë mbi 16 vjeç kërkohet lejeqëndrimi me afat të paktën një vjeçar. Në këto raste nënshkruhet **Marrëveshja e Integrimit**.

*Marrëveshja e integrimit (e parashikuar nga Dekreti Legjislativ 286/1998, neni 4 bis) është një marrëveshje ndërmjet Shtetit italian dhe shtetasit të huaj që hyn në Itali për herë të parë.*
*Shtetasit e huaj marrin përsipër të respektojnë të gjitha detyrat e përcaktuara në 'Kartën e vlerave të qytetarëve dhe të Integrimit'.*

Informacionet në lidhje me marrëveshjen tuaj të integrimit mund të konsultohen në portalin ALI në menunë rënëse "marrëveshja e integrimit".

**Në muajt pas hyrjes së parë, qytetari do të marrë thirrjen në CPIA (Qendra Provinciale e Edukimit të të Rriturve) në Reggio Emilia.**

## REGJISTRIMI NË GJENDJEN CIVILE

Për ata që kanë kërkuar lëshimin e lejeqëndrimit për arsye familjare (bashkim familjar), është e mundur të kërkojnë regjistrimin në Regjistrin e Gjendes Civile Kombëtare të Popullsisë Rezidente (rezidencën) edhe përpara se të marrin lejen e qëndrimit, duke iu drejtuar sporteleve te Zyra e Gjendjes Civile e Komunës, duhet të paraqesin, në vend të lejeqëndrimit, këto dokumente:

**PASAPORTË ME VIZË HYRJE**

**DËFTESË E LËSHUAR NGA ZYRA POSTARE E CILA DËSHMON SE ËSHTË BËRË PARAQITJA E KËRKESËS PËR LEJEQËNDRIM**

**KOMUNIKIM NGA SPORTELI UNIK I EMIGRACIONIT ME TË CILIN KOMUNIKOHET LËSHIMI I AUTORIZIMIT TË SHKARKUAR NGA PORTALI ALI**

Neni 29, paragrafi 3 germa a) e b), e D.Lgj. 286/98

Prefettura di Reggio Emilia
POSTER POtenziamento Servizi Territoriali per il dialogo intERculturale
FONDAZIONE E35 PER LA PROGETTAZIONE INTERNAZIONALE
Centro Interculturale MONDINSIEME Intercultural Centre
caleidos COOPERATIVA SOCIALE